

V E N D I M
Nr.19, datë 17.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtar	“““
Manol Konomi,	Anëtar	“““
Veli Budo,	Anëtar	“““
Franc Jakova,	Anëtar	“““
Alfred Karamuço,	Anëtar	“““
Zija Vuci,	Anëtar i“““	

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.26 Akti, që i përket:

K Ë R K U E S E: PARTIA AGRARE E SHQIPERISE, e përfaqësuar nga kryetari Z. Lufter Xhuveli.

PALË E INTERESUAR: KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga Z. Kreshnik Spahiu.

O B J E K T I :

Shfuqizimi i Vendimit nr.434, datë 13.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për mosregjistrimin e kandidatëve të Partisë Agrare në listën për mandatet shtesë.

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia Agrare e Shqipërisë si subjekt elektoral ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 27.4.1996 listën me mandatet shtesë të kandidatëve për deputetë në Kuvendin Popullor.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin nr.434, datë 13.5.1996 ka vendosur mosregjistrimin e kandidatëve të Partisë Agrare në listën për mandatet shtesë me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit ligjor.

Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe shpjegimet e palëve u vërtetua se listat me mandatet shtesë janë paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve jashtë afatit ligjor të përcaktuar në nenin 15 të Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996.

Shkaqet që parashitroi pala kërkuese lidhur me vonesën në paraqitjen e listës, nuk janë të bazuara. Subjekti elektoral i ka siguruar dokumentet e nevojshme për paraqitjen e listës së kandidatëve më datën 26.4.1996 në ora 1100 dhe nuk ka patur asnjë pengesë objektive për t’i paraqitur ato brenda asaj date.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 50 të Ligjit Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, njëzëri,

V E N D O S I :

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot më datë 17.5.1996

